

YURA CORPORATION ALBANIA SH.P.K

Pasqyrat Financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

29 Janar 2025

Permbajtja:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ME 31 DHJETOR 2024	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024	2
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL MË 31 DHJETOR 2024	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Politika të përgjithshme kontabël	5
3. Gjykimet dhe vlerësimet kryesore kontabël	11
4. Menaxhimi i riskut financiar	11
5. Adoptimi i standarteve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara	13
6. Aktive Afatgjata Materiale	14
7. Aktive Afatgjata Jo Materiale	15
8. Inventarët	15
9. Të drejtat e arkëtueshme	16
10. Të arkëtueshme të tjera	16
11. Parapagimet	16
12. Shpenzime të shtyra	17
13. Mjete monetare	17
14. Kapitali	17
15. Huamarrjet	17
16. Furnitore, detyrime të tjera dhe detyrimet tatimore	18
17. Detyrimet tatimore	18
18. Të ardhura	19
19. Kosto e shitjes	19
20. Shpenzime personeli	20
21. Shpenzime administrative	20
22. Fitimi/(humbje) të tjera	20
23. Shpenzime dhe të ardhura financiare	20
24. Tatim fitimi	21
25. Instrumentat financiare	22
26. Angazhimet dhe aktivet/detyrimet e kushtëzuara	24
27. Transaksionet me palët e lidhura	25
28. Shënime të tjera	26
29. Ngjarjet pas mbylljes së vitit ushtrimor	27

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë Yura Corporation Albania sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Yura Corporation Albania sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyre më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikes për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikes për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikes të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacioni tjetër

Drejtimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin që jepet në Raportin Vjetor, të përgatitur nga drejtimi, dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tone të auditimit mbi to.

Raporti ynë mbi këto pasqyra financiare nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj tjetër konkluzioni që jep sigurië mbi to.

Ne lidhje me auditimin tone të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe, gjatë këtij procesi, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është në mënyre materiale jo konsistent me pasqyrat financiare ose me njohuritë e përfituara gjatë auditimit ose nëse në dukje është në mënyre materiale i gabuar.

Nëse, bazuar në punën që ne kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se ka gabime material në informacionin tjetër, atëherë ne duhet ta raportojmë këtë fakt. Në datën e lëshimit të këtij raporti, Shoqëria akoma nuk e ka publikuar informacionin tjetër. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me të

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidoje Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa me sipër.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marre, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marre deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që në mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Nexia AL
Auditues Ligjor
Orjana Kalaja

Tirana, Albania
31 janar 2025



YURA CORPORATION ALBANIA SH.P.K*(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ME 31 DHJETOR 2024**

	Shënimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Aktivët			
Aktivët Afatgjatë			
Aktive Afatgjatë Materiale	6	806,265,384	858,477,517
Aktive Afatgjatë Jomateriale	7	9,306,155	16,834,159
		815,571,539	875,311,676
Aktivët Afatshkurtra			
Inventari	8	925,270,583	715,698,907
Të drejta të arkëtueshme	9	590,373,364	129,821,827
Të arkëtueshme të tjera	10	50,556,578	59,055,307
Parapagimet	11	10,910,466	7,852,671
Shpenzime të shtyra	12	4,807,820	4,839,244
Mjete Monetare	13	315,391,154	547,055,294
		1,897,309,965	1,464,323,250
Aktivët Totale		2,712,881,504	2,339,634,926
Kapitalet e veta			
Kapitali i paguar	14	571,136,000	128,651,000
Humbje të mbartura		(166,961,233)	52,524,411
Humbja e periudhës		(215,885,271)	(219,485,644)
Totali i kapitaleve të veta		188,289,496	(38,310,233)
Detyrimet			
Detyrimet Afatgjatë			
Huamarrje	15	-	-
Detyrime Afatshkurtra			
Huamarrje	15	147,752,556	436,816,269
Furnitore e detyrime të tjera	16	2,366,486,962	1,930,662,650
Detyrime tatimore afatshkurtra	17	10,352,490	10,466,240
		2,524,592,008	2,377,945,159
Totali i detyrimeve		2,524,592,008	2,377,945,159
Totali i kapitaleve të veta dhe detyrimeve		2,712,881,504	2,339,634,926

Pasqyrat financiare të paraqitura duhet të lexohen bashkë me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5-27, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 27 janë të miratuara dhe të firmosura në 31 Janar 2025 nga:

Administratori

YONGBAE KIM



Përgatitur:

Inter BBK Auditing SHPK



YURA CORPORATION ALBANIA SH.P.K*(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024**

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Të ardhurat	18	5,682,933,897	5,898,444,500
Kosto e mallrave të shitura	19	(5,340,985,486)	(5,718,109,927)
Fitimi nga aktiviteti kryesor		341,948,411	180,334,573
Shpenzime të personelit	20	(147,348,871)	(186,142,081)
Shpenzime amortizimi dhe konsumi	6,7	(18,831,619)	(19,276,564)
Shpenzime administrative	21	(458,913,554)	(300,860,013)
Fitim/humbje të tjera	22	-	6,157,058
Fitimi operativ		(283,145,633)	(319,787,027)
Të ardhura financiare	23	205,398,263	326,885,332
Shpenzime financiare	23	(138,137,901)	(225,261,988)
Shpenzimet financiare - neto	23	67,260,362	101,623,344
(Humbja) /Fitimi para tatimit		(215,885,271)	(218,163,683)
Shpenzim tatim fitimi	24	-	(1,321,961)
(Humbja) / Fitimi nga operacionet e vijueshme		(215,885,271)	(219,485,644)
Humbja / Fitimi nga operacionet jo-të vijueshme		-	-
(Humbja) / Fitimi nga operacionet jo të vijueshme		(215,885,271)	(219,485,644)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Fitimi nga rivleresimi i aktiveve afatgjata</i>		-	-
<i>Fitim/(Humbjet) nga vlera e drejtë e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga investimet</i>		-	-
<i>Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja</i>		-	-
<i>Tatimi mbi të ardhurat për zerrat që nuk do të riklasifikohen</i>		-	-
Totali i (humbjes) / fitimit gjithëpërfshirës për vitin		(215,885,271)	(219,485,644)

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5–27, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



YURA CORPORATION ALBANIA SH.P.K*(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024**

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Humbja e vitit		(215,885,271)	(219,485,644)
<i>Korigjime për:</i>			
Humbje nga kurset e këmbimit	23	(67,260,362)	(101,623,344)
Shpenzime amortizimi dhe konsumi	6,7	86,477,527	85,841,182
Tatim fitimi		-	1,321,961
Fluksi i parasë nga aktiviteti operativ		(196,668,106)	(233,945,845)
(Rritje) / Rënie e inventareve	8	(209,571,676)	185,716,708
(Rritje) / Rënie e të drejtave të arkëtueshme	9,10,11,12	(455,079,179)	227,869,790
Rritje / (Rënie) e të drejtave të pagueshme	16,17	502,970,924	243,853,578
Fluksi neto i parasë nga aktiviteti operativ		(358,348,037)	423,494,231
Fluksi i parasë nga aktiviteti investues			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6,7	(26,737,390)	(6,685,114)
Fluksi neto i parasë nga aktiviteti investues		(26,737,390)	(6,685,114)
Aktivitetet e Financimit			
Rritje kapitali aksionar		442,485,000	-
Marrje/ (ri-pagesë) e huave bankare e të tjera	15	(289,063,713)	(164,723,846)
Fluksi neto i parasë nga aktiviteti financues		153,421,287	(164,723,846)
Rritja/(pakësimi) neto në mjete monetare	13	(231,664,140)	252,085,271
Mjete monetare në 1 Janar	13	547,055,294	294,970,023
Mjete monetare në 31 Dhjetor 2024		315,391,154	547,055,294

Pasqyra e fluksit të parës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5–27, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



YURA CORPORATION ALBANIA SH.P. K*(Te gjitha shumat jane shprehur ne Leke, pervecse kur percaktohet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL MË 31 DHJETOR 2024**

	Kapitali i paguar	Humbjet e mbartura	Kapitali total
Balanca në 31 Dhjetor 2022	128,651,000	52,524,411	181,175,411
Humbja e periudhës	-	(219,485,644)	(219,485,644)
Balanca në 31 Dhjetor 2023	128,651,000	(166,961,233)	(38,310,233)
Zmadhim kapitali	442,485,000	-	442,485,000
Humbja e periudhës	-	(215,885,271)	(215,885,271)
Balanca në 31 Dhjetor 2024	571,136,000	(382,846,504)	188,289,496

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5–27, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



YURA CORPORATION ALBANIA SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Yura Corporation Albania SH.P.K. (më poshtë “Shoqëria”) është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Tiranë më 25 Prill 2018. Adresa e selisë së shoqërisë është në Rrugën “Aulona”, Lagjja 16 Prilli, Ish - Baza e Tubove. Aktiviteti kryesor i shoqërisë është prodhimi i paketave elektrike dhe pjesëve automobilistike në Shqipëri.

Shoqëria zotërohet nga Yura Corporation (100.00%).

Në 31 Dhjetor 2024, shoqëria kishte 1,915 të punësuar (31 Dhjetor 2023: 1,886 të punësuar). Numri mesatar i të punësuarve për vitin 2024 ishte 1,915 të punësuar.

2. Politika të përgjithshme kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e kostos historike. Pasqyrat financiare janë paraqitur në lekë. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë.

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi parimin e vijueshmërisë. Referojuni Shënimit më poshtë për paqartësitë dhe ngjarjet, si dhe kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar mbi parimin e vijueshmërisë.

2.2 Vijueshmëria

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë. Shoqëria ka filluar aktivitetin si një shoqëri e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, më 17 Maj 2018, dhe ka filluar prodhimin në Shkurt 2020.

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024, Shoqëria njohu një humbje prej 215,885,271 lekë (31 Dhjetor 2023: humbje prej 219,485,644 lekë).

Në mënyrë që Shoqëria të plotësonte nevojat e saj për likuiditet dhe të vazhdonte pa ndërprerë operacionet, më 5 dhjetor 2024, ortakut i vetëm i shoqërisë vendosi për rritjen e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë në shumën 4,500,000 Euro (në shumën ekuivalente në lekë 442,485,000). Përveç kësaj, Yura Slovakia është zotuar, përmes një letrë mbështetëse të datës 21 janar 2025, të mbështesë Shoqërinë për të përmbushur detyrimet e saj për të ardhmen e parashikueshme.

Bazuar në pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, dhe në pasigurinë që rrethon zhvillimin e ardhshëm të shpërthimit, menaxhmenti vlerëson se ajo nuk do të ketë nevojë për financim shtesë për të përmbushur detyrimet e saj financiare.

Prandaj, aktivet dhe pasivet regjistrohen mbi bazën që njësia ekonomike do të jetë në gjendje të realizojë aktivet e saj dhe të shlyejë detyrimet e saj gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

YURA CORPORATION ALBANIA SH.P. K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Politika të përgjithshme kontabël (vazhdim)

2.3. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël (vazhdim)

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë është leku shqiptar ("ALL"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha në të cilën raportohen këto pasqyra financiare.

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen në monedhën funksionale në normën e përcaktuar në datat e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja rivendosen në kursin e këmbimit që vendoset në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në valutë për zerat monetarë është diferenca që rezulton nga përkthimi i një numri të caktuar të njësive të një monedhe të huaj në lekë me kurse të ndryshme të këmbimit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë janë këmbyer në lekë me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga ritranslacioni njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kursi i këmbimit në fund të vitit, 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023, është paraqitur si më poshtë:

Monedha	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EUR/LEK	98.15	103.88
USD/LEK	94.26	93.94

b) Instrumentat Financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme, investimet e mbajtura deri në maturim dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë marrë investimet. Menaxhimi përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë përcaktim në çdo datë raportimi.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivët ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale mbi aktivin financiar në një transaksion në të cilin, në thelb, të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivëve transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose pasiv i veçantë.

Një detyrim financiar nuk çregjistrohet kur detyrimi sipas kontratës zbatohet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si de-njohja e pasivit fillestar dhe njohja e një përgjegjësie të re. Diferenca në vlerën kontabël neto njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Aktivët dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë njëkohësisht. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, paranë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, dhe detyrimet tregtare dhe të tjera.

Shoqëria nuk ka aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, të mbajtura deri në maturim ose të vlefshme për shitje

YURA CORPORATION ALBANIA SH.P. K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Politika të përgjithshme kontabël (vazhdim)

2.3. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël (vazhdim)

b) Instrumentat Financiare (vazhdim)

Të drejtat dhe të tjera të arkëtueshme

Të drejtat dhe të tjera të arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Pas matjes fillestare, aktivet e tilla financiare maten më pas me koston e amortizuar, minus zhvlerësimi. Humbjet që rrjedhin nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kostot financiare për huatë dhe në koston e shitjeve ose shpenzimet e tjera operative për të arkëtueshmet. Për më shumë informacion mbi të arkëtueshmet, referojuni shënimit 9.

Mjete Monetare

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë bilancet e parave të gatshme dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllimet e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare, paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra, siç janë përcaktuar më sipër, neto nga mbitërheqjet e papaguara të bankave.

c) Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale janë paraqitur me kosto historike, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve.

Shpenzimet e mëposhme përfshihen në vlerën kontabël të aktiveve ose njihen si një aktiv i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e elementit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Amortizimi aplikohet në bazë të metodës lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Amortizimi është i ngarkuar kur aktivi është i gatshëm për përdorimin e synuar, duke konsideruar ndryshimin e politikës, edhe pse në rastin konkret nuk ka ndikim pasi nuk ka shtesa të reja. Jeta e dobishme e vlerësuar dhe e zbatuar paraqitet si më poshtë:

Klasifikimi	Vitet
Paisjet Informatike	5
Mjetet e Transportit	5
Mobilje dhe paisje zyre	5
Ndertesa	40
Makineri	10
Struktura	20

Vlera e mbetur e aktivitet dhe jeta e dobishme

Vlera e mbetur e aktivitet dhe jeta e dobishme rishikohen dhe përshtaten nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël e një aktivi zbritet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël neto e aktivitet tejkalon shumën e rikuperueshme.

Një zë i aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e konsiderueshme e njohur fillimisht regjistrohet kur përdoret ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose asgjësimi i tij. Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihen neto në "të ardhurat e tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

YURA CORPORATION ALBANIA SH.P. K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Politika të përgjithshme kontabël (vazhdim)

2.3. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël (vazhdim)

d) Aktivet Afatgjata Jo Materiale

Aktivët afatgjata jomateriale janë paraqitur me kosto historike, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet mbi bazë lineare gjatë jetës së dobishme të aktivitetit. Jeta e dobishme e vlerësuar dhe e zbatuar paraqitet si më poshtë:

Klasifikimi	Vitet
Licencë kompjuterike	5

e) Zhvlerësimi

Aktive financiare

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidence objektive që ai është i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nëse evidencat objektive tregojnë se një ose më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të ardhshme të vlerës së atij aktivi.

Shoqëria do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit për njohjen dhe matjen e shumës së humbjes për aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Megjithatë, provizioni për humbje do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe do të zvogëlojë vlerën kontabël të aktivitetit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria do të masë provizionin për humbjen e një instrumenti financiar në një shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë gjatë jetës së saj nëse rreziku i kredisë i këtij instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.

Për vitin 2024, menaxhimi nuk ka njohur ndonjë provizion humbjeje për të arkëtueshmet pasi gjykon se nuk ka ndonjë rrezik të pritshëm të kredisë.

Balanca e të arkëtueshmeve më 31 Dhjetor 2024 i përket Shoqërisë Yura Slovakia s.r.o dhe Yura Serbia, të cilat janë palë të lidhura me Shoqërinë. Balanca përfaqëson shitjet e muajve Nëntor dhe Dhjetor 2024, të papaguara ende në 31 Dhjetor 2024. Sipas politikës së Grupit, Shoqëria do të njohë një humbje të pritur nga mosarkëtimi nëse ka kaluar një periudhë prej 360 ditësh.

Aktive jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktiv, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse një tregues i tillë ekziston, atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohej me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parës dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga zhvlerësimi rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën e aktivitetit që duhej të përcaktohej neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

2. Politika të përgjithshme kontabël (vazhdim)

2.3. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël (vazhdim)

f) Përfitimet e punonjesve

Sigurim i detyrueshëm shoqëror

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të cilat përcaktojnë përfitimet e punonjesve që dalin në pension. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit i ngarkohen fitimit ose humbjes kur ato ndodhin..

g) Kapitali

Kuotat e kapitalit të emetuara klasifikohen si kapital aksionar.

h) SNRF 16 Qirate

Një qiramarrës njihet një të drejtë për të përdorur aktivin që përfaqëson të drejtën për të përdorur këtë aktiv dhe, në të njëjtën kohë, përbën një detyrim qiraje në lidhje me detyrimin për të ripaguar pagesat e qirasë financiare. Ekzistojnë disa përjashtime opsionale për qira afatshkurtra dhe qira për aktive me vlerë të vogël. Kontabiliteti i qiradhënësit mbetet shumë i ngjashëm me standardin aktual – për shembull, pronari do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si financiare ose operative.

Kërkesat e SNRF 16 nuk janë të aplikueshme për Shoqërinë pasi ambientet e marra me qira konsistojnë në apartamente akomodimi të shfrytëzuara nga stafi i huaj. Këto qira operative konsistojnë në qira apartamentesh afatshkurtra për stafin korean.

Njësia ekonomike ka njohur pagesat e qirasë në lidhje me këtë kontratë si një shpenzim mbi një bazë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Shpenzimi i qirasë është shpalosur në Shënimin 21 – Shpenzimet Administrative.

i) Provizionet

Të përgjithshme

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe parashikohen flukse dalëse mjeteshe monetare për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të mjeteve monetare me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parave dhe për rreziqet specifike të detyrimit.

j) Të ardhurat

Të ardhurat nga shitja e mallrave vlerësohen me vlerën e drejtë të shumave të arketuara ose të pritshme për t'u arketuar, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, akciza, kthimet dhe zbritjet tregtare dhe financiare. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të lidhura me pronësinë transferohen tek blerësi, kur ka mundësi që përfitimet të lidhura me shitjen të hyjnë në Shoqëri, kostot dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, drejtimi nuk përfshihet më në administrimin dhe kontrollin efektiv të mallrave dhe kur vlera e të ardhurave mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

YURA CORPORATION ALBANIA SH.P. K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Politika të përgjithshme kontabël (vazhdim)

2.3. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël (vazhdim)

k) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse me metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi baza neto.

l) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, përveç rasteve kur njohja bëhet drejtpërdrejt në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin e miratuar në datën e raportimit. Detyrimet dhe aktivet tatimore të shtyra kompensohen nëse ka një marrëveshje ligjore për t'i kompensuar dhe nëse ato lidhen me tatime mbi fitimin të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që është e mundshme që të ketë përfitime të ardhshme tatimore të vlefshme ndaj të cilave diferencat e përkohshme mund të rimerren.

Më 31 Dhjetor 2024, shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë.

3. Gjykimet dhe vlerësimet kryesore kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve, si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese shoqëruese, si dhe zbulimin e detyrimeve të kushtezuara. Pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve ose detyrimeve të prekura në periudhat e ardhshme.

Vlerësimet dhe supozimet

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar të ardhshëm, përshkruhen më poshtë. Shoqëria ka bazuar supozimet dhe vlerësimet e saj mbi parametrat në dispozicion kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Megjithatë, rrethanat ekzistuese dhe supozimet rreth zhvillimeve të ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të tregut ose rrethanave që dalin jashtë kontrollit të Shoqërisë. Këto ndryshime reflektohen në supozimet kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Zhvlerësimi ekziston kur vlera bartëse e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme, e cila është më e lartë midis vlerës së saj të drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës së saj në përdorim. Vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes bazohet në të dhënat e disponueshme nga transaksionet e detyrueshme të shitjeve, të kryera në krahun e tyre, për aktivet e ngjashme, ose çmimet e tregut të vëzhguara minus kostot shtesë të vendosjes së aktivit.

4. Menaxhimi i riskut financiar

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor i operacioneve të Shoqërisë. Rreziqet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Shoqëria janë ato që lidhen me rrezikun e tregut, që përfshin çmimin, normën e interesit dhe rreziqet e monedhës, rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

